



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 01.03.2017

Ref.: 123/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 48-të, të mbajtur më 23 shkurt 2017, mori:

V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa nr.647/16, dt. 07.11.2016 e BPrAL Kolegji "Iliria" për ri/akreditim të programeve të studimit:
  - Inxhinieri Softverike, MSc (120 ECTS);
  - Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA (120 ECTS);
  - Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA (120 ECTS), me specializime: Menaxhment dhe Informatikë; Banka, Financa dhe Kontabilitet; Biznes Ndërkombëtar; Menaxhment Shëndetësor.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Iliria" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit Inxhinieri Softverike, MSc (120 ECTS); Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA (120 ECTS); Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA (120 ECTS), me specializime: Menaxhment dhe Informatikë; Banka, Financa dhe Kontabilitet; Biznes Ndërkombëtar; Menaxhment Shëndetësor.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2017 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Iliria", dhe pas shqyrtimit të dosjeve të stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet për aprovim, dhe më këtë rast ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të BPrAL Kolegji "Iliria" për programet e cekura në dispozitiv.


1/2

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të ofruar nga BPrAL Kolegji "Iliria", KSHC konstatoj se ka mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për këto programe të studimit, dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje, KSHC mori vendim për refuzim të aplikacionit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.


Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Iliria";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë





# KOLEGJI ILIRIA

Licencuar nga Ministria e Arimit, Shkencës dhe Teknologjive - Akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Rruga Gërmend Zajmi Nr.75 Prishtinë, Tel: +381 (0) 38 233 931 E-mail: info@vultra.org Web: www.vultra.org

No. Prot: 647MG Data: 07.11.2016  
Ebroj Prot: Prot No: Datum: 07.11.2016  
Prishtinë / a

**Prishtinë, 18 Tetor 2016**

**Për:** Agjencinë e Kosovës për Akreditim

**Nga:** Mr. Arbër Reçi, Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit ILIRIA

**Lënda:** Kërkesë për akreditim dhe riakreditim të programeve

Kërkojmë nga Agjencia e Kosovës për Akreditim që të pranojë kërkesën e Kolegjit ILIRIA për akreditim dhe riakreditim të programeve vijuese të studimit, sipas formularëve dhe materialit përkatës të dorëzuar:

**Programet për Akreditim, Niveli Bachelor (gjuhë Angleze dhe Turke):**

1. Arkitekturë (Specializimet: Arkitekturë; Planifikim Hapësinor dhe Ambient) / BSc 240 ECTS
2. Inxhinieri (Specializimet: Hartografi; Gjeofizikë; Inxhinieri e Mjedisit; Inxhinieri e Ndërtimtarisë) / BSc 240 ECTS
3. Shkenca Shëndetësore (Specializimet: Menaxhim i Shëndetit; Terapi fizikale dhe rehabilitim; Ushqim dhe Dietologji) / BSc 240 ECTS
4. Turizëm (Specializimet: Menaxhim i Turizmit; Gastronomi dhe Arti i Kuzhinës) / BA 240 ECTS
5. Farmaci / BSc 240 ECTS
6. Gjuhë dhe Letërsi Turke (Turkologji) / BA 240 ECTS

**Programet për Akreditim, Niveli Bachelor (gjuhë Shqipe):**

7. Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (Specializimet: Menaxhment dhe Informatikë; Banka, Financa dhe Kontabilitet; Biznes Ndërkombëtar) / BA 180 ECTS

**Programet për Akreditim, Niveli Master (gjuhë Shqipe):**

8. Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (Specializimet: Menaxhment dhe Informatikë; Banka, Financa dhe Kontabilitet; Biznes Ndërkombëtar; Menaxhment Shëndetësor) / MA 120 ECTS

**Programet për Riakreditim, Niveli Master:**

9. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci / MA 120 ECTS
10. Inxhinieri Softverike / MSc 120 ECTS

Kësaj kërkesë i bashkangjesim edhe dokumentet përcjellëse të nevojshme për t'iu nënshtruar procesit të akreditimit.

Me respekt,

Mr. Arbër Reçi

Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit ILIRIA

